

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Energjisë

LIÇENCË PËR OPERIMIN E SISTEMIT TE
TRANSMETIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE

Numri i Liçensës:

Certifikata e Regjistrimit:

Seria:

Data e Hyrjes në Fuqi:

Liçenca i jepet:

Shoqeria:

Kodi Fiskal:

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në seksionin e dyte të Pjesën e Peste të Ligjit Nr.43/2015 “Për Energjinë Elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”) i jep këtë Liçencë (“Liçenca”), për të kryer veprimtarinë e operatorit të transmetimit të energjise elektrike (TEE), subjektit të lartpërmendur, i quajtur “I Liçensuari”, subjekt i Kushteve të Liçencës të bashkëngjitura dhe pjesë integrale të saj, si dhe kushteve të percaktuara në Vendimin e Bordit të ERE.

Kjo Liçencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi, deri në përfundim të afatit të kësaj liçense ose kur hiqet nga ERE në përputhje me Kushtet e Liçencës të përfshira këtu.

KRYETAR I ERE-s

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Energjisë

LIÇENCË
PËR
OPERIMIN E SISTEMIT TE TRANSMETIMIT TE ENERGJISE
ELEKTRIKE

Seria: _____

Numri i Liçensës: _____

I jepet: _____

(Emri i plotë i të Liçensuarit)

KUSHTET E LIÇENCËS
PËR
OPERIMIN E SISTEMIT TE TRANSMETIMIT TE ENERGJISE
ELEKTRIKE

Numri i Liçensës: _____

Seria: _____

I jepet: _____
(Emri i plotë i të Liçensuarit)

1. Dispozita të Përgjithshme

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur në Pjesën e Katërt të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” për të lëshuar këtë Liçencë dhe deklaruar hyrjen në fuqi të saj.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj Liçencë bëhet nul apo pushon së qeni në fuqi, ky kusht do të hiqet nga Liçenca dhe Kushtet e mbetura të Liçencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Asetet nuk mund të transferohen tek asnjë Person tjetër pa aprovimin paraprak me shkrim të ERE. Kur aprovon një transferim, ERE mund ta ndryshojë periudhën e Liçencës ose Kushtet e tjera të Liçencës.

1.4. ERE ka të drejten ekskluzive për të ndryshuar këtë license, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar si dhe për të përmbushur dispozitat e Rregullave të Tregut, Kodit të Rrjetit, Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Matjes të miratuara nga ERE sipas Legjislacionit në fuqi.

1.5 Në Republikën e Shqipërisë do të jepet vetëm një liçencë për Aktivitetin e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike

1.6 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në Liçencë, Kushtet e Liçencës dhe Anekset, kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Enti Rregullator i Energjisë” ose “ERE” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për sektorin e gazit natyror.

“Operatori i Rrjetit” është operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes.

“Operatori i Sistemit të Transmetimit” ose “OST” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afagjate të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike

“Operimi i tregut” është veprimtaria që kryen operatori i tregut lidhur me menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe përgatitjen e raporteve financiare për pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e rregullave të tregut.

“Operatori i tregut” është struktura përgjegjëse e licencuar për operimin, organizimin dhe menaxhimin e tregut të energjisë elektrike.

“Certifikim” është procedura, e cila përcakton përputhshmërinë me kushtet që sigurojnë pavarësinë dhe ndarjen e operatorit të Sistemit të Transmetimit, sipas përcaktimeve të ligjit të cituar më sipër.

“Aktivitete të energjisë elektrike” janë aktivitete ekonomike që lidhen me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike, si dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

“Bordi” është organi vendimmarrës i ERE-s, i emëruar sipas këtij ligji të cituar më sipër

“Dispeçerimi” është veprimtaria e kryer nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, që konsiston në menaxhimin në kohë reale të flukseve të energjisë elektrike dhe zbatimin e masave të nevojshme për operimin e bashkërenduar të komponentëve të sistemit elektroenergjetik, përfshirë centralet prodhuese, rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse të nevojshme për operimin e sistemit.

“Licencë” është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

“Ligji” në këtë akt do të kuptohet në çdo rast ligji nr 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”

“Legjislacioni” janë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra në zbatim e në funksion të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike dhe ato mbi të cilat ushtron veprimtarinë tregëtare i licencuari.

“Modeli i tregut të energjisë elektrike” është një dokument i përgatitur dhe i miratuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili përcakton marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut të energjisë elektrike.

“Rregullat e tregut” janë rregulla të hollësishme, të cilat përcaktojnë mënyrën e operimit dhe menaxhimit të tregut, regjistrimin e pjesëmarrësve, përgjegjësinë e balancimit prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, rregullat për llogaritjen e disbalancës për palët përgjegjëse të balancimit, rregullat për përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të balancimit në rast të disbalancimit, si dhe çështje të tjera lidhur me funksionimin e tregut.

“Eksport i deklaruar” është dispeçerimi i energjisë elektrike që i korrespondon sasisë së energjisë elektrike që lëvrohet njëkohësisht në një vend tjetër si import i deklaruar mbi bazën e një marrëdhënieje kontraktuale.

“ENTSO-e (European Network of Transmission System Operators for Electricity) është Rrjeti European i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

“Furnizim” është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te klientët.

“I licencuar” është një person i pajisur me licencë për aktivitete të energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

“Operatori Sistemit të Shpërndarjes” ose “OSSH” është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

“Operator i Rrjetit” është operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

“Pala përgjegjëse për balancimin” është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij, përgjegjës përballë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për disbalancat e krijuara gjatë operimit të tij.

“Palët e Komunitetit të Energjisë” janë palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Bashkimi European dhe shtetet anëtare të tij.

“Person” është një person juridik i organizuar në një nga format e parashikuara në ligjin Nr 9901, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” ndryshuar, dhe i rregjistruar pranë QKR.

“Përdoruesit e sistemit” janë personat fizikë ose juridikë, të cilët i furnizon ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes.

“Përgjegjësia e balancimit” është një detyrim i pjesëmarrësve të tregut për balancimin e prodhimit, konsumit, proceseve të shitblerjes së energjisë elektrike, në përputhje me programin e pranuar, duke qenë përgjegjës financiarisht kundrejt Operatorit të Sistemit të Transmetimit për sistemimin e disbalancave të krijuara.

“Ofrues i shërbimit të balancimit” është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike, që siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të

Transmetimit, në bazë të një kontrate për pjesëmarrje në tregun e balancimit, në përputhje me rregullat e balancimit të sistemit elektrik.

“Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike” është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatori i tregut. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

“Kodet e Rrjetit” janë Kodi i Transmetimit dhe Kodi i Shpërndarjes. “Kodi i Shpërndarjes” është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, si dhe vendosin kushtet e shërbimit që ofrohen nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.

“Kodi i Transmetimit” është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-e.

“Kodi i Matjes” është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike.

“Siguruesi i shërbimeve të balancimit” është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike, i cili siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, bazuar në kontratën për pjesëmarrjen në tregun e balancimit, sipas rregullave përkatëse të sigurimit të balancimit të sistemit të energjisë elektrike.

“Sistemi i energjisë elektrike” është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet elektrike, linjat elektrike, nënstacionet dhe pajisjet e transmetimit e shpërndarjes, me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e energjisë elektrike te klientët.

“Sistemi i shpërndarjes” është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.

“Sistemi i transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçësepër lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

“Shërbimi i balancimit” është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

“Shërbime ndihmëse” janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.

“Shoqëri elektroenergjetike” është një person fizik ose juridik që kryen të paktën një nga veprimtaritë: prodhim, transmetim, shpërndarje, furnizim ose blerje të energjisë elektrike, i cili është përgjegjës për detyrimet tregtare, teknike ose të mirëmbajtjes, lidhur me këto veprimtari, pa përfshirë klientët fundorë.

“Shpërndarje” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.

“Import i deklaruar” është energjia elektrike që lëvrohet në një vend, e cila, në të njëjtën kohë, dispeçerohet si eksport i deklaruar nga një vend tjetër.

“Interkonektor” është një linjë transmetimi e ndërtuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose një palë e tretë, e cila kalon nëpërmjet kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe të një vendi tjetër dhe lidh sistemet kombëtare të transmetimit të të dyja vendeve.

“Interkonektor i ri” është një interkonektor i papërfunduar dhe/ose i përfunduar por i pakomisionuar, deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

“Tranzit i deklaruar” është sasia e energjisë elektrike që vjen nga një vend tjetër, e cila nuk konsumohet në vend, por kalon në një vend të tretë.

“Tregu i balancimit” është menaxhimi, i bazuar në treg, i funksioneve të balancimit të sistemit të energjisë elektrike, i operuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

“Tregu i organizuar i energjisë elektrike” është platforma e organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë.

“Tregu i energjisë elektrike” është një sistem ku kryhen shitje dhe blerje efektive, përfshirë edhe derivativët e energjisë elektrike, nëpërmjet kërkesave dhe ofertave, të paraqitura në periudha afatgjata dhe afatshkurtra.

“Tregtar” është çdo person juridik, i cili kryen veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

“Tregtimi i energjisë elektrike” është procesi që kryhet nga një person juridik që blen energji elektrike, me qëllim rishitjen e saj brenda ose jashtë sistemit të vendit ku kryen veprimtarinë.

“Forcë madhore” është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

“Furnizim” është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te klientët.

“Furnizues” është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.

“Biznesi Shoqërues” Çdo biznes që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht:

- a) është pronë e të Liçensuarit; ose
- b) ka të Liçensuarin në pronësi; ose
- c) është në pronësi të Personit, i cili është pronë e të Liçensuarit.

“Ndër-subvencionimet” Transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të Liçensuarit ose mes Bizneseve Shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.

2. Kryerja e Aktivitetit të Liçensuar

2.1 I Liçensuari autorizohet nga kjo Liçencë për të kryer Aktivitetin e

Transmetimit të Energjise Elektrike ne Republiken e Shqiperisë. Kjo e drejte i jepet ekskluzivisht të Liçensuarit.

2.2 I Licensuari nuk do të vendosë pagesa për Shërbimet e Transmetimit ose Shërbimet Ndhmëse, përveç kur autorizohet nga Tarifat ShT të aprovuara nga ERE herë pas here sipas Legjislacionit në fuqi dhe Rregulloreve dhe Rregullave të ERE.

2.3 I Liçensuari do të përdorë dhe mirëmbajë Sistemin e Transmetimit në përputhje me

Kodin e Transmetimit dhe Vendimet e Qeverise se Republikes se Shqiperise,
Rregulloreve dhe Rregullave të ERE, dhe kushteve të kesaj
Liçence, akteve te tjera ligjore ne fuqi për te siguruar
feksionimin dhe koordinimin efiçent dhe kontrollin e Sistemit
Elektroenergjitik të Republikes se Shqiperise.

2.4 I Liçensuari, pa diskriminim do të siguroje lidhjen me Sistemin e Transmetimit për të gjithë përdoruesit si duke garantuar transmetimin e energjise elektrike qe ata kane kontraktuar ndermjet tyre.

2.5 I Liçensuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të tentojë të parandalojë të liçensuarit e tjerë ose pjesmarresit potenciale ose konkurentet qe të angazhohen ose të hyjne:

- a) në biznesin e aktiviteteve në sektorin e energjise elektrike në Republikën e Shqiperise;
- b) në biznesin e importimit ose eksportimit të energjise elektrike në ose nga Republika e Shqiperise, me perjashtim kur i Liçensuari udhezohet ndryshe nga Legjislacioni në fuqi.

2.6 I Liçensuari nuk do të angazhohet në Nder-Subvencionime. Nëse i Liçensuari është një kompani vertikalisht e integruar elektroenergjitike, do t'i ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktiviteteve të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes brenda afatit të kërkuar nga Legjislacioni në fuqi në mënyrë të mjaftueshme për të mundësuar që ERE të konkludojë se nuk ka nder-subvencionime, aktivitete anti-konkurrence ose diskriminim.

2.7 I Liçensuari nuk do të angazhohet në asnjë formë aktiviteti monopol ose anti-konkurrence të ndaluar nga Legjislacioni në fuqi

2.8 I Liçensuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë pasqyra financiare, të cilat do të mbahen të ndara për Aktivitetin e Liçensuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licensuara) ku është angazhuar i Liçensuari, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe procedurat e miratuara nga ERE dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për Kontabilitetin dhe Ligjin. I Liçensuari do t'i dorëzojë ERE-s pasqyrat financiare vjetore brenda datës 31 Janar të vitit pasardhës ushtrimor.

2.9 Gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, i Liçensuari është i detyruar të sigurojë jetën dhe shëndetin e njerëzve si dhe pasurinë e tyre në përputhje me Legjislacionin në fuqi

2.10 I Liçensuari nuk do të bashkëpunojë me persona të tjerë për të dëmtuar të liçensuarit ose Kliente të përfshirë në Sistemin Elektroenergjitik. I Liçensuari mund të bashkëpunojë me Persona të tjerë për çështje që lidhen me rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe modernizimit të sistemit elektroenergjitik.

2.11 I Liçensuari do t'a kryejë Aktivitetin e Licensuar në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomike dhe objektivin e arritjes së kostos më të ulët pa rrezikuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e Sistemit të Transmetimit.

2.12 I Liçensuari do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar efikasitetin operativ dhe ekonomik të Aktivitetit të Licensuar dhe do të sigurojë nivelet e kërkuara të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike sipas Rregulloreve dhe Rregullave të miratuara nga ERE.

2.13 I Liçensuari do të hartojë dhe nxisë politika dhe programe që synojnë të respektojnë standartet e cilësisë dhe qëndrueshmërisë të vendosura për Sistemin e Transmetimit, sipas Rregulloreve dhe Rregullave të ERE-s.

2.14 I Liçensuari nuk do të angazhohet në aktivitete të tjera që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen e Aktivitetit të Liçensuar. I Liçensuari duhet të informojë ERE-n në rastet kur synon të :

- a) angazhohet në aktivitete tjetër përveç aktivitetit të liçensuar; ose
- b) të ngrejë një Biznes Shoqërues.

2.15. I Liçensuari do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo Biznesi Shoqërues. ERE-ja mund ta ndalojë ose të vendosë kushte të veçanta për ngritjen e Bizneseve Shoqëruese të nevojshëm për të mbrojtur interesat e konsumatorëve.

2.16. I Liçensuari është i autorizuar të vendosë pagesa për sigurimin e Sherbimeve Ndhimese.

Tarifat e Sherbimeve Ndhimese llogariten sipas Metodologjise se Llogaritjes se Kostove të Sherbimeve Ndhimese dhe në përputhje me Tarifat e Sherbimeve Ndhimese të regjistruara dhe aprovuara nga ERE.

2.17. I Liçensuari nuk është përgjegjës për mos-përmbushjen e Kushteve të Licencës në rast të një Force Madhore deri në atë shkallë sa Forca Madhore është shkaku për këtë mos-përmbushje të Kushteve të Liçences. Në këtë rast, i Liçensuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe të liçensuarit e tjerë ose Klientet me të cilët i Licensuari ka lidhur Kontrata për Transmetimin e Energjisë Elektrike.

3. Detyrimet e të Liçensuarit

3.1. I Liçensuari është i detyruar të zbatojë Legjislacionin në fuqi.

3.2. **Llogaritë dhe Raportimi**

3.2.1. I Liçensuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për Aktivitetin e Liçensuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licensuara) ku është angazhuar i Licensuari, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe procedurat e miratuara nga ERE dhe në legjislacionin në fuqi. I Liçensuari do t'i dorëzojë ERE-s bilance financiare vjetore brenda datës 31 Janar të vitit pasardhës ushtrimor. Të liçensuarit, që operojnë në tregun e energjisë elektrike, gjithashtu janë të detyruar të depozitojnë kopjen e audituar të pasqyrave financiare, brenda dates 31 Qershor të vitit pasardhës.

3.2.2. Nëse i Liçensuari parashikon një situatë emergjente siç përcaktohet nga Legjislacioni në fuqi, i Liçensuari do të njoftojë pa vonesë ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë i Licensuari për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuar.

3.2.3. I Liçensuari do të ndajë shpenzimet e përbashketa mes Aktivitetit të tij të Liçensuar dhe tipeve të tjera të aktiviteteve (përfshirë aktivitetet e autorizuara nga një i Liçensuar tjetër) në baze të arsyeshme në përputhje me Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s dhe praktikatat e biznesit përgjithësisht të pranuar. I Liçensuari do t'i paraqesë ERE-s, me kërkesën e tij, në formën dhe në afatin e vendosur nga ERE, dokumentacionin që vendos bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashketa mes aktiviteteve që do të ushtrohen, si dhe rezultatet e arritura pas kesaj ndarje.

3.2.4. I Licensuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 diteve për çdo ndryshim të:

- a) adresës;
- b) statutit të të Liçensuarit;
- c) certifikates së regjistrimit;
- d) kodit fiskal;
- e) organet kryesore drejtuese; ose
- f) strukture së aseteve me mbi 10%.

Nëse i Liçensuari nuk e bën këtë njoftim, ERE mund të aplikojë gjykojë, sipas Ligjit.

3.2.5. Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, pretendimet ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me Liçencën duhet të jete me shkrim dhe të nënshkruara respektivisht nga një zyrtar i autorizuar ose perfaqësues i caktuar i të Licensuarit ose ERE-s, dhe të dërgohet me korrier ose poste të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e Paleve

duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjeter do të konsiderohen se hyjne në fuqi nga momenti i dorezimit, ose nese nuk jane dorezuar përshkak të gabimit të derguesit, nga momenti i prezantimit.

(Ndryshimet si tek licensat e shperndarjes/furnizimit)

3.3. Përdorimi i Informacionit

3.3.1 I Liçensuari do të siguroj q çdo informacion i marr si rezultat i Aktivitetit të tij të Liçensuar nuk do ti jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pelqim paraprak me shkrim i Personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) informacioni është bërë publik;
- c) kur të Licensuarit i kërkohet ose lejohet të përhapë informacionin për të përmbushur Kushtet e kësaj Liçence sipas një urdhëri të ERE-s, ose çdo dispozite ligjore të aplikueshme; ose
- d) informacioni duhet perhapur në rrjedhen normale të kryerjes se aktivitetit të Liçensuar.

3.3.2 I Liçensuari do të siguroje qe çdo Biznes Shoqerues nuk do të perdore asnje informacion të të Liçensuarit për te fituar nje avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të siguroje qe nuk do të perhape asnje informacion tek ndonje Person tjetër (përfshirë Biznese të tjere Shoqerues) qe mund ta mundesojne kete Person të fitojë çdo lloj perfitimi komercial të pajustificuar.

3.3.3. Informacioni i derguar ERE-s nga i Liçensuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kerkese specifikë të të Liçensuarit, ERE me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.

3.4. Kontrolli i Centralizuar dhe Koordinimi i Rrjetit të Transmetimit të Energjise Elektrike

3.4.1. I Liçensuari do të drejtoje dhe koordinoje operimin e Sistemit të Transmetimit në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s.

3.4.2. Për të siguruar nje Aktivitet Dispeçerues të koordinuar dhe nje operim sa me efektiv dhe të qendrueshem të Sistemit të Transmetimit, i Liçensuari do t'i instalojë, përdorë dhe mirëmbajë pajisjet e nevojshme për te siguruar mbrojtjen e Sistemit Elektroenergjitik nga gabimet operuese, humbjet e befasishme të

ngarkeses ose kapacitetit gjenerues, ose çdo ngjarje tjetër të mundshme me ndikim të dëmshëm në punën normale të tij.

3.4.3. I Liçensuari do të sigurojë Sherbime Ndhimese në përputhje me Kodin e transmetimit dhe me Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s.

3.5. **Regjistrimi dhe Sistemi i Raportimit**

3.5.1. I Liçensuari do të regjistrojë çdo ore, gjithë flukset elektrike që hyjnë ose dalin nga Sistemi i Transmetimit, përfshirë energjinë e transmetuar nepermjet përdorimit të rrjetit nga vende të treta. Në vendet ku nuk ka matës ose ku matësat nuk i regjistrojnë këto flukse, i Liçensuari do të përcaktojë sasinë në ore të këtyre flukseve elektrike sipas Procedurave Operative efektive dhe do të ndermarre pa vonesë masa për të instaluar pajisjet matëse të duhura.

3.5.2. I Liçensuari do të përgatisë raporte mujore të detajuara mbi hyrjen dhe daljen e flukseve elektrike, operimin e Sistemit të Transmetimit, bilancin energjistik, flukset e jashtëzakonshme elektrike, Sherbimet Ndhimese të siguruara, transmetimin e energjisë elektrike nga dhe për në vendet e treta dhe detaje të tjera mbi operimin e Sistemit të Transmetimit dhe do t'ia paraqesë ERE-s këtë informacion periodikisht çdo muaj.

3.5.3. Çdo muaj, i Liçensuari do t'ua paraqesë të gjithë Përdoruesve të ST, me të cilët ka përfunduar kontrata për sigurimin e Sherbimeve të Transmetimit të Energjisë Elektrike informacionin e përmendur në pikën 3.5.2 si dhe të dhëna mbi energjinë elektrike të transmetuar.

3.5.4. Paga për energjinë elektrike të transmetuar nga dhe për në vendin e treta nga i Liçensuari, si dhe për Sherbimet Ndhimese të siguruara prej tij, është detyrim i Përdoruesve të Sistemit të Transmetimit, konsumatoreve dhe Personave që transmetojnë energji elektrike nepermjet përdorimit të rrjetit nga vendi i treta.

3.6. **Ndryshimet në Sistemin e Transmetimit**

3.6.1. I Liçensuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo rrethane që çon në ndryshime të rëndësishme të kapacitetit transmetues të linjave dhe stacioneve transformuese të Sistemit të Transmetimit, për një periudhë me shumë se tridhjetë (30) ditë dhe do t'ia japë ERE-s

nje opinion për zgjidhjen me të pershtatshme tranzitore për të reduktuar ndikimin e demshem.

3.6.2. I Liçensuari do të informoje ERE-n për qellimet për reduktimin e linjave të tensionit të larte ose transformatoreve të Sistemit të Transmetimit të pakten dymbëdhjete (12) muaj para reduktimit të planifikuar dhe do t'i siguroje ERE-s nje shpjegim të detajuar të veprimeve të synuara dhe masave që do të merren për të reduktuar ndikimin e mundshem të demshem.

3.6.3. I Liçensuari do të informoje menjehere ERE-n për çdo instalim ose shkëputje të linjave të tensionit të lartë, transformatoreve dhe pajisjeve të tjera.

3.6.4. I Liçensuari do të njoftoje ERE-n dhe palet e tjera të interesuara mbi çdo mosfunksionim ose rrezik të rastit që ndodh në Sistemin e Transmetimit si dhe për kushtet e sistemit gjate ketyre ngjarjeve. I Liçensuari do të paraqese brenda pese (5) diteve pas kesaj ngjarje, nje raport me shkrim që pershkruan shkaqet e ngjarjeve të permendura, masat e marra, si dhe masat që do të parandalojne ose kufizojne perseritjen në të ardhmen të ketyre ngjarjeve.

3.6.5. I Liçensuari do të ndertoje dhe mirembaje Sistemin e Transmetimit duke siguruar kapacitetin e mjaftueshem të nevojshem për te permbushur kerkesat e gjithë Perdoruesve të ST, duke e zgjeruar dhe modernizuar ate sipas nevojës. Nese i Liçensuari synon të ndertoje facilitete të reja të Sistemit të Transmetimit (perfshire linja të tensionit të larte, stacione transformimi), do t'ja paraqese ERE-s sipas procedurave të miratuara dhe do t'i mbeshtese keto plane me studime fizibiliteti, preventive, oponente dhe informacionin mbi te ardhurat dhe burimet e financimit.

3.6.6. Brenda dates 15 Shkurt të çdo viti, i Liçensuari do t'i paraqese ERE-s nje raport mbi kushtet e Sistemit të Transmetimi, problemet ekzistuese dhe zgjidhjet për t'i kapercyer, sipas nje formati të percaktuar nga Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s.

3.6.7. Brenda dates 31 Mars të çdo viti, i Liçensuari do t'i paraqese ERE-s propozime mbi zhvillimet afat-shkurtra dhe afat-gjata të kostove me të ulta të Sistemit të Transmetimit sipas nje raporti format të përcaktuar në Rregullat e ERE-s.

3.7. Tarifat e Sherbimeve Transmetuese dhe ato të Perdorit të Sistemit të Transmetimit nga Sistemet Transmetuese të rajonit

3.7.1. Tarifat e Sherbimeve Transmetuese (Tarifat e ShT) dhe Tarifate e Sherbimeve të perdorit të sistemit të transmetimit nga Sistemet Transmetuese të rajonit (tarifat ShTSTR) rregullohen dhe aprovohen nga ERE.

3.7.2. Në baze të Legjislacionit në fuqi dhe Rregulloreve dhe Rregullave të ERE-s, i Liçensuari mund të kerkojë në ERE për të Ndryshuar tarifat ShT dhe ShTSTR ekzistuese për nje shkak të arsyeshem të provuar.

3.7.3. I Liçensuari do të autorizohet të vendose pagesa mbi Perdoriesit e ST për kryerjen e sherbimeve të transmetimit, me kusht qe keto pagesa të jene sipas Tarifave ST dhe ShTSTR, të aprovuara nga ERE. Sasia e pagesave do të percaktohet në baze të Tarifave ShT dhe ShTSTR dhe sasise se energjise elektrike të regjistruar nga matesat e instaluar në:

- a) kufirin e Sistemit të Transmetimit dhe Rrjetit të Shperndarjes;
- b) kufirin e Sistemit të Transmetimit dhe Konsumatoreve qe marrin energji elektrike nepermjet lidhjes direkte me Sistemin e Transmetimit; dhe
- c) nderlidhjet me Sisteme të tjera Transmetimi.

3.7.4. Tarifat ShT dhe ShTSTR të aprovuara nga ERE do të vendosen për te siguruar

të Licensuarin me:

- a) te ardhura të mjaftueshme për te mbuluar nivelet e arsyeshme të kostove perfshire kostot kapitale; dhe
- c) stimuj për te reduktuar kostot dhe për te operuar në menyre me efçente.

3.7.5 ERE mund të korrigoje Tarifate ShT dhe ShTSTR here pas here në perputhje me Legjislacionin në fuqi.

3.7.6. I Liçensuari mund t'i propozojë ERE-s amendamente në Metodologjine e Llogaritjes se Tarifave ShT dhe ShTSTR për te permiresuar perputhjen e tyre me kostot reale për sigurimin e Sherbimeve të Transmetimit nga ana e tij.

3.8. **Akresi dhe Lidhja me Sistemin e Transmetimit**

3.8.1. I Licensuari është i detyruar t'i sigurojë akses të drejte, të arsyeshem dhe jo-diskriminues Perdoruesve të rrjetit në përputhje me parashikimet e ligjit

3.8.2. I Liçensuari duke njoftuar përdoruesit e sistemit, mund të pezullojë Sherbimet e Transmetimit sipas Kushteve të Liçences për çdo periudhe kohe, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.9. **Detyrime të tjera**

3.9.1. I Liçensuari do të planifikojë, brenda tre muajve pas lëshimit të Liçencës, dhe do t'i propozojë ERE-s për aprovim Metodologjine e

Llogaritjes se Kostove për Sherbimet Ndhimese. Metodologjia e Llogaritjes se Kostove për Sherbimet Ndhimese, si dhe amendamentet e saj do të hyjnë në fuqi pas aprovimit nga ERE, por mund të mos përfshijnë kostot e marra në konsideratë për llogaritjen e Tarifave ShT dhe ShTSTR. Pagesat për Sherbimet Ndhimese do të përcaktohen në mënyrë që i Licensuari të mbulojë shpenzimet e arsyeshme për sigurimin e këtyre shërbimeve.

3.10. Pagesat e Rregullimit

3.10.1. I Licensuari do t'i paguajë ERE-s pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj Liçence siç përcaktohet nga ERE në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe rregulloret e aplikueshme të ERE-s.

3.10.2. Nëse i Licensuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit në përputhje me Nenin 17 të Ligjit, i Licensuari do të penalizohet në përputhje me Nenin 107, të Ligjit.

4. Kontrolli mbi Kryerjen e Aktivitetit të Liçensuar

4.1. ERE do monitorojë zbatimin nga i Licensuari të Kushteve të Licensimit, do të shqyrtojë raportet e marra nga i Licensuari dhe, në çdo kohë pas njoftimit, është i autorizuar të inspektojë asetet ose regjistrimet e llogarive dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabel të aktivitetëve të të Licensuarit.

4.2. Perfaqësuesit e autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të hyjnë në ndertesat e të Licensuarit, pajisjet dhe dokumentat për të inspektuar Aktivitetin e Liçensuar në përputhje me Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s. I Licensuari do të sigurojë çdo ndihmë të kërkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij inspektimi.

4.3. Në bazë të ankësës së vertetuar të çdo Personi të tretë ose në bazë të iniciativës së tij, ERE mund të nisë një hetim për zbatimin e

Kushteve të Liçences ose Rregulloreve dhe Rregullave të ERE-s, përfshirë shqyrtimin e praktikave të biznesit nga të Licensuarit lidhur me Aktivitetin e Liçensuar.

4.4. Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i Liçensuari nuk ka zbatuar Kushtet e Liçences, ERE mund të korrigojë tarifën e të Licensuarit dhe/ose të ndermarre masa të tjera me qëllim që të mbrojë interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike, deri në heqjen e kësaj Liçence.

4.5. I Liçensuari do të informojë ERE-n për çdo shkelje të ketyre Kushteve të Licences brenda një jave që kjo shkelje i bëhet e njohur të Licensuarit.

4.6. I Liçensuari do të zbatojë të gjitha vendimet e nxjerra nga ERE, përfshirë pagesën e plote të gjobave të vendosura nga ERE-ja, në përputhje me Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s, për shkeljen e Kushteve të Liçences.

5. Modifikimi i Liçences

5.1. ERE mund të amendojë Kushtet e Liçences në rast se ato nuk përputhen me:

- a) Legjislacionin në fuqi dhe Vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që janë në përputhje me Legjislacionin në fuqi;
- b) Vendimet e nxjerra nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ose një Gjykatë tjetër Shqiptare me kompetencë juridiksionale.
- c) Me iniciativë të të licensuarit.

5.2. Amendamentet e bera në Kushtet e Liçences do të bëhen me vendimmarrje të ERE-s dhe i nënshtrohen rregullave të Praktikës dhe Procedurës.

6. Heqja e Liçencës

6.1. ERE mund të heqë Liçensën në përputhje me Ligjin dhe

Legjislacionin në fuqi:

- a) i Liçensuari kërkon revokimin e liçencës;
- b) i Liçensuari shkel Kushtet e Liçencës;
- c) i Liçensuari shkel Legjislacionin në fuqi;
- d) i Liçensuari deklarohet i falimentuar dhe është i paafte të përmbushë detyrimet e parashikuara në Kushtet e Liçencës;
- e) i Liçensuari ka marrë liçencë duke mashtruar.

6.2. Nëse i Liçensuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksioneri që kontrollon interesat ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, Liçenca bëhet nul (e pavlefshme) ose anulohet dhe pasuesi i të Licensuari mund të aplikojë për një liçencë të re në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie liçencë.

7. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe e Drejta për Apelim

7.1. Çdo çështje e diskutueshme ose kerkese mes të Liçensuarit dhe çdo Perdoruesi të ST lidhur me Aktivitetin Dispeçerues ose Kushtet e Liçences do të zgjidhet sa me shume që të jete e mundur me mirekuptim, në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s.

7.2. Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE-ja në bazë të një kerkese të çdo Personi që është palë në këtë mosmarreveshje do ta zgjidhë mosmarreveshjen dhe do të nxjerre vendimin e saj në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe Rregulloret dhe Rregullat e saj.

7.3. I Liçensuari mund të kundërshtojë vendimet e ERE-s në përputhje me ligjin dhe rregulloret e ERE-s.

7.4. I Liçensuari duhet t'u bindet vendimeve të ERE-s në pritje të vendimit të Gjykates Administrative Tiranë ose të ndonjë gjykate tjetër të Republikës së Shqipërisë me kompetence juridiksionale.